

Ne i mbështesim fuqimisht të  
Drejtat e Njeriut

---

# Politika për të Drejtave të Njeriut

Qershor 2025

v1.4

# Përmbajtja

|                                                                                   |          |
|-----------------------------------------------------------------------------------|----------|
| <b>Qëllimi</b>                                                                    | <b>3</b> |
| <b>Fushëveprimi dhe Zbatimi</b>                                                   | <b>3</b> |
| <b>Përgjegjësitë tuaja</b>                                                        | <b>3</b> |
| <b>Fushat ku shkeljet e të Drejtave të Njeriut mund të ndodhin më së shpeshti</b> | <b>3</b> |
| 1. jeta, liria dhe siguria                                                        | 3        |
| 2. Mosdiskriminimi                                                                | 3        |
| 3. Jeta familjare                                                                 | 4        |
| 4. Liria e asociimit                                                              | 4        |
| 5. Puna e fëmijëve                                                                | 4        |
| 6. Skllavëria dhe puna e detyruar                                                 | 4        |
| <b>Udhëzues për Procedurat Parandaluese</b>                                       | <b>4</b> |
| 1. Vlerësimi i Rrezikut                                                           | 4        |
| 2. Komunikimi                                                                     | 4        |
| 3. Monitorimi dhe rishikimi                                                       | 4        |
| 4. Si të paraqiten shqetësimet                                                    | 4        |
| <b>Shkeljet</b>                                                                   | <b>5</b> |
| <b>Shtojca A</b>                                                                  | <b>5</b> |
| 1. Legjislacioni për të Drejtat e Njeriut                                         | 5        |

## Qëllimi

Respektimi i të drejtave të njeriut është një nga parimet thelbësore të Grupit TITAN, ashtu siç pasqyrohet në Kodin tonë të Mirësjelljes. Ne jemi të përkushtuar për të mbrojtur dhe avancuar të drejtat e njeriut dhe synojmë të promovojmë respektimin e të drejtave të njeriut në kuadër të fushave tona të ndikimit.

Kjo Politikë drejtohet nga parimet e parapara në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut, Pakti Ndërkombëtar i të Drejtave Civile dhe Politike dhe Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (shih Shtojcën A). Kjo Politikë synon të rrisë ndërgjegjësimin dhe të sigurojë respektimin e të drejtave të njeriut në të gjithë Grupin, duke ndërtuar dhe ruajtur reputacionin tonë si një korporatë e përgjegjshme.

## Fushëveprimi dhe Zbatimi

Kjo Politikë zbatohet në **TITAN S.A. dhe në subjektet që ajo zotëron ose në të cilat mbanë shumicën e aksioneve (Grupi Titan).**

Parimet e Politikës pritet gjithashtu të zbatohen nga partnerët dhe bashkëpunëtorët e Grupit TITAN, siç janë kontraktuesit dhe furnitorët.

Në zbatimin e Politikës, ne i nënshtrohemi ligjeve të vendeve në të cilat veprojmë dhe jemi të përkushtuar të zbatojmë të gjitha ligjet e tilla në fuqi. Aty ku Politika jonë, procedurat dhe zotimet tona të jashtme janë më rigorozë se ligjet vendore, ne veprojmë në përputhje me standardet tona. Kur ligji lokal na ndalon të zbatojmë aspekte të caktuara të Politikës, ne i zbatojmë këto ligje lokale, dhe përpiqemi të zbatojmë praktikën më të mirë.

## Përgjegjësitë tuaja

Çështjet e të drejtave të njeriut mund të hasen në çdo ndërveprim personal që mund të kemi si menaxherë, mbikëqyrës, kolegë ose partnerë biznesi. Prandaj, të gjithë punonjësit e Grupit TITAN duhet të lexojnë, të kuptojnë dhe të sigurohen që veprimet e tyre të jenë në përputhje me Politikën.

Të gjithë punonjësit e Grupit TITAN inkurajohen fuqimisht të njihen me të drejtat ndërkombëtare të njeriut, për shembull duke iu referuar materialit të siguruar nga Komisioneri i Lartë i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut (OHCHR) në ueb faqen: [www.ohchr.org](http://www.ohchr.org) dhe të marrin pjesë në çdo trajnim dhe punëtori shtesë të ofruar brenda kompanisë.

## Fushat ku shkeljet e të Drejtave të Njeriut mund të ndodhin më së shpeshti

Më poshtë është një listë minimale dhe e pakufizuar e fushave ku mund të ndodhin shkeljet e të drejtave të njeriut si dhe qëndrimi ynë përkatës. Paraqitja e kësaj liste nuk heq përgjegjësinë tonë për të mbrojtur të gjitha të drejtat e njeriut të renditura në Shtojcën A.

### 1. Jeta, liria dhe siguria

Ne kërkojmë të ofrojmë një mjedis të shëndetshëm dhe të sigurt në punë, në përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi si dhe me Politikën tonë të brendshme për Shëndetin dhe Sigurinë.

Ne sigurojmë kushte të shëndetshme dhe të sigurta të punës, qasje në ujë të pijshëm, vende për sanitari dhe pastrim dhe, kurdoherë që është e nevojshme, bujtina të mira, dhoma për fjetje, mensa dhe ambiente për ruajtjen e ushqimit.

Ne sigurojmë një vend pune pa dhunë, ngacmim ose frikësim. Personeli i sigurisë është i punësuar sipas nevojës për mbrojtjen e aseteve të kompanisë dhe njerëzve tanë, duke vepruar gjithmonë sipas udhëzime specifike të shkruara të cilat ndjekin praktikën e mirë ndërkombëtare.

### 2. Mosdiskriminimi

Ne e vlerësojmë shumëllojshmërinë e njerëzve me të cilët punojmë. Ne nuk e tolerojmë diskriminim ose ngacmim. Ne promovojmë mundësi të barabarta dhe përfshirje në bazë të çdo karakteristike duke përfshirë: **atë demografike**, të

tilla si mosha, gjinia, raca, përkatësia etnike, aftësia fizike, orientimi seksual ose origjina kombëtare; **eksperimentale**, të tilla si shkathtësitë, aftësitë, arsimi, talenti, prejardhja dhe kultura; dhe **njohëse**, siç janë mënyrat e të menduarit, personaliteti dhe stili.

### 3. Jeta familjare

Ne respektojmë dhe mbështesim të drejtën e punonjësve tanë për amësi dhe jetë familjare. Ne përpiqemi të përmirësojmë ekuilibrin mes punës dhe jetës, duke dhënë mbështetje të shërbimit social siç përcaktohet nga kushtet dhe pritshmëritë lokale. Shembuj mund të jenë përfitimet sociale për familjet, si dhe programe dhe ngjarje speciale të adresuara për të gjithë familjen, etj.

### 4. Liria e asociimit

Ne respektojmë lirinë e asociimit dhe të drejtën për negociata kolektive. Kur punonjësit formojnë një shoqatë të njohur ligjërisht, ne angazhohemi në një dialog konstruktiv me të.

### 5. Puna e fëmijëve

Ne nuk punësojmë asnjë person nën moshën 18 vjeç. Ne mund të ofrojmë mundësinë e stazhit në punë/praktikës për personat më të rinj pas një procedure arsimore të aprovuar nga brenda ose nga jashtë.

### 6. Skllavëria dhe puna e detyruar

Ne ndalojmë përdorimin e të gjitha formave të punës së detyruar ose të detyrueshme, duke përfshirë punën e detyruar për shlyerje të borxhit, ndëshkimin trupor, detyrimin mendor ose fizik dhe ngacmimin seksual, abuzimin seksual dhe verbal.

Dokumentet e identifikimit të punëtorëve nuk mbahen për asnjë arsye.

## Udhëzues për Procedurat Parandaluese

### 1. Vlerësimi i Rrezikut

Identifikimi dhe priorizimi i fushave të përgjithshme brenda secilit operacion ku rreziku i ndikimeve të pafavorshme ndaj të drejtave të njeriut është përgjegjësi e menaxhmentit lokal. Një vegël e shpejtë për vlerësimin e të drejtave të njeriut (në dispozicion përmes Punëve të Brendshme të Grupit) mund të përdoret për të mbështetur dhe verifikuar procesin. Vlerësimi i rrezikut për të drejtat e njeriut ndryshon nga menaxhimi i rrezikut komercial, teknik dhe financiar pasi që nuk ka të bëjë me vlerësimin e rreziqeve vetëm për kompaninë, por edhe për të drejtat e të tjerëve. Një vlerësim i tillë i rrezikut duhet të kryhet në të gjitha bizneset tona dhe të jetë pjesë e procesit të vlerësimit në çdo bashkim, blerje ose ndryshim thelbësor operacional. Veç kësaj, pasi situatat mund të ndryshojnë, duhet të bëhen edhe rishikime periodike të përshtatshme.

Veprimet përmirësuese, kur janë të nevojshme, duhet të dokumentohen dhe monitorohen.

### 2. Komunikimi

Qasja jonë e tolerancës zero ndaj shkeljeve të të drejtave të njeriut duhet t'u komunikohet të gjithë furnitorëve, kontraktuesve, agentëve dhe partnerëve të biznesit në fillim të marrëdhënies sonë me ta si dhe më vonë sipas nevojës.

### 3. Monitorimi dhe rishikimi

Auditimi i Brendshëm dhe/ose Përgjegjësia Shoqërore Korporative (PShK) duhet të monitorojë dhe rishikojë efektivitetin dhe zbatimin e Politikës.

### 4. Si të paraqiten shqetësimet

Nëse besoni ose dyshoni se shkelja e një të drejte njerëzore do të ndodhë, po ndodh ose ka ndodhur, duhet ta raportoni menjëherë te:

- Menaxheri Juaj i Linjës dhe/ose
- Departamenti Juaj Ligjor Lokal ose
- Platforma e raportimit (EthicsPoint)

Nëse keni ndonjë pyetje ose kërkonti sqarime në lidhje me Politikën, ju lutemi kontaktoni menaxherin tuaj të linjës dhe/ose Departamentin tuaj Ligjor lokal.

## Shkeljet

Çdo punonjës që shkel Politikën mund t'i nënshtrohet sanksioneve disiplinore, përfshirë ndërprerjen e marrëdhënies së punës, në përputhje me ligjet dhe rregulloret lokale. Kur një veprim është gjithashtu në kundërshtim me ligjin, punonjësi mund të jetë objekt i ndjekjes penale sipas ligjit civil ose penal.

## Shtojca A

### 1. Legjislacioni për të Drejtat e Njeriut

#### Standardet Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut: Karta e të Drejtave

Karta Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut përbëhet nga (1) **Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut** e cila i rëndit të gjitha të drejtat e njeriut, (2) **Pakti Ndërkombëtar i të Drejtave Civile dhe Politike**, dhe (3) **Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore** ku këto të drejta klasifikohen në detyrime konkrete për shtetet.

**Tabela 1: Standardet për punën e korporatave**

| Të Drejtat Civile dhe Politike                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                  |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                     | Të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                        | Të Drejtat e Punës                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                |
|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                           |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                     | Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                 | 8 konventat e Organizatës Botërore të Punës                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                       |
| 1. E drejta për vetëvendosje;<br>2. E drejta e jetës;<br>3. E drejta për të mos iu nënshtuar torturës dhe as dënimeve ose trajtimeve mizore, çnjerëzore e poshtëruese;<br>4. E drejta për të mos iu nënshtuar skllavërisë, gjendjes së nënshkrimit apo punës së detyruar;<br>5. E drejta e lirisë dhe sigurisë së një personi;<br>6. E drejta e personave të paraburgosur për trajnim njerëzorë;<br>7. E drejta për të mos u burgosur nga pamundësia e përmbushjes së një kontrate;<br>8. E drejta për liri të lëvizjes;<br>9. E drejta e të huajve për proces të drejtë kur ballafaqohen me dëbim;<br>10. E drejta për gjykim të drejtë;<br>11. E drejta për të qenë i lirë nga ligji penal retroaktiv ( <i>prapaveprues</i> ) | 12. E drejta që të njihet personaliteti juridik;<br>13. E drejta për privatësi;<br>14. Të drejtat e lirisë së mendimit, ndërgjegjes dhe fesë;<br>15. Të drejtat e lirisë së mendimit dhe shprehjes;<br>16. Të drejtat e lirisë nga propaganda e luftës, dhe liria nga nxitja e urrejtjes racore, fetare apo kombëtare;<br>17. E drejta për lirinë e mbledhjes/tubimit;<br>18. E drejta e lirisë së asociimit/bashkimit;<br>19. Të drejtat për mbrojtjen e familjes dhe e drejta për martesë;<br>20. Të drejtat për mbrojtjen e fëmijës;<br>21. E drejta për të marrë pjesë në jetën publike;<br>22. E drejta e barazisë para ligjit, dhe e drejta e mosdiskriminimit;<br>23. Të drejtat e pakicave. | 1. E drejta për vetëvendosje;<br>2. E drejta për punë;<br>3. E drejta për të gëzuar kushte punë të drejta dhe të favorshme;<br>4. E drejta për të formuar sindikata dhe për t'iu bashkuar sindikatave, dhe e drejta e grevës;<br>5. E drejta për sigurinë shoqërore, duke përfshirë sigurimin social;<br>6. E drejta për jetën familjare;<br>7. E drejta për standarde adekuate të jetesës;<br>8. E drejta për shëndetin;<br>9. E drejta për arsim;<br>10. E drejta e pjesëmarrjes në jetën kulturore, e gëzimit të përfitimeve nga progresi shkencor, dhe të drejtat materiale e morale e autorëve dhe shpikësve. | 1. Liria e Asociimit dhe Mbrojtja e të Drejtës për Organizim të Konventës, 1948 (Nr. 87)<br>2. E drejta për organizim dhe negociatë kolektive, 1949 (nr. 98)<br>3. Konventa e Punës së Detyruar, 1930 (Nr. 29)<br>4. Shfuqizimi i Konventës së Punës së Detyruar, 1957 (Nr. 105)<br>5. Konventa e Moshës minimale, 1973 (Nr. 138)<br>6. Konventa për format më të këqija të Punës së Fëmijëve, 1999 (Nr. 182)<br>7. Konventa e Shpërblimit të Barabartë, 1951 (Nr. 100)<br>8. Konventa e Diskriminimit (Punësimi dhe Profesionit), 1958 (Nr. III) |

**Parimet Udhëzuese për Biznesin dhe të Drejtat e Njeriut:** Zbatimi i Kornizës së Kombeve të Bashkuara "Mbroni, Respektoni dhe Kompenzoni"

**Mbroni:** detyra e shtetit për të ofruar mbrojtje nga abuzimet e të drejtave të njeriut nga palët e treta, përfshirë bizneset, përmes politikave, rregulloreve dhe gjyqimeve të përshtatshme.

**Respektoni:** përgjegjësia e korporatës për të respektuar të drejtat e njeriut, që do të thotë se bizneset duhet të shmangin shkeljen e të drejtave të njeriut dhe të adresojnë ndikimet e padëshirueshme në të cilat ato mund të përfshihen.

**Kompenzoni:** nevoja për një qasje më të madhe për kompenzim efektiv për viktimat të cilave u janë abuzuar të drejtat e njeriut nga biznesi, si përmes rrugëve gjyqësore ashtu edhe atyre jo-gjyqësore.